



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 146

Tiranë – E martë, 18 korrik 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10567, datë 12.7.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	6975
Dekret i Presidentit nr. 10568, datë 12.7.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	6975
Dekret i Presidentit nr. 10569, datë 12.7.2017	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	6975
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 14.7.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shtimi i sipërfaqes së varrezave publike Tufinë”, Tiranë.....	6976
Urdhër i ministrit të Financave nr. 73, datë 5.7.2017	Për delegim kompetence.....	6977
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 91, datë 4.7.2017	Për fillimin e procedurave për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, për OSHEE sh.a.....	6977
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 92, datë 4.7.2017	Për fillimin e procedurave për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, për KESH sh.a.....	6978
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 93, datë 4.7.2017	Për licencimin e shoqërisë “PPC Albania” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6979
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 94, datë 4.7.2017	Mbi rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6980
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 95, datë 4.7.2017	Mbi miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror..	6981

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 4.7.2017	Mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”.....	6987
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 4.7.2017	Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror.....	6987
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 98, datë 4.7.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë të propozuar nga OST sh.a.....	6999
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 99, datë 4.7.2017	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017.....	7000
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 100, datë 4.7.2017	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Luçente koncensionare” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike....	7001
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 101, datë 4.7.2017	Mbi fillimin e procedurës për lënien peng të aseteve të shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k., në favor të bankës “Raffaisen Bank” sh.a.....	7002
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 102, datë 4.7.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	7003

**DEKRET****Nr. 10567, datë 12.7.2017****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Hajredin Nezir Kuçi
2. Fatmire Nevzat Kuçi (Jerliu)
3. Alaudin Muhamet Hamiti
4. Nazim Avdi Sahiti
5. Shpend Enver Maxhuni

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 10568, datë 12.7.2017****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Deqiang Nianzu Huang
2. Guozhan Weidong Huang
3. Yuanfeng Qingzhao Lu
4. Simin Guoquan Luo
5. Yuxian Wenzhi Deng
6. Kangbo Renguang Tang

7. Jinwei Manzhen Chi
8. Wenling Guanggui Li
9. Yan Huihong Wang
10. Haoyu Yan Wang
11. Changqing Renxiang Jiang
12. Jiarong Xichang Mai
13. Changfeng Jiarong Mai
14. Xiao Zhengliang Fu
15. Chunmei Chengyuan Yang
16. Bin Huajun Zhang
17. Yu Tinggui Xu
18. Tung Yin Tai Leung Lai
19. Ronghuo Yutian Lai

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

DEKRET**Nr. 10569, datë 12.7.2017****PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Agustin Dilaver Poçi
2. Qimo Thodhor Muço (Muco)
3. Ukë Sulejman Lushaj
4. Mimoza Hamza Meta (Haruni)
5. Esmalda Xhevdet Meta
6. Rron Xhevdet Meta
7. Enkelejda Halil Karapici
8. Enkeleda Nustref Isufi
9. Arta Sulejman Këputa
10. Arsild Adrian Këputa
11. Ervin Fadil Kasa
12. Ermira Hajdar Aliu
13. Argent Ervin Kasa
14. Gjokë Dodë Gjonkolaj



15. Barbara Tonin Ejlli
16. Mehmet Hysen Gabraj
17. Marie Panajot Fischer (Selmanaj)
18. Ernard Rami Hasanaj
19. Arsen Ferit Kaci
20. Lulzim Bashkim Tulani
21. Alfred Xhevat Mjeda
22. Xhimi Islam Dervishi Sterzel (Dervishi)
23. Evis Koço Nehring (Stathi)
24. Fatbardha Gëzim Musabelli (Koni)
25. Mirjeta Enver Shllaku (Hereni)
26. Eglantina Hamdi Duri (Koçi/Koci)
27. Robert Adem Mero
28. Amanda Arben Ferizi
29. Dritan Bekim Haskaj
30. Anteos Lavdosh Lalaj
31. Ditmir Shuaip Dedja
32. Jolanda Qamil Prinz (Lika)
33. Daniel Namik Mezini
34. Shkelzen Rrustem Aliaj
35. Irsa Sheuqet Toska
36. Ilir Dilaver Ngucaj
37. Pejana Arben Çavolli
38. Vjollca Isuf Megjidi (Pici)
39. Leonard Hasan Luka
40. Zhaneta Shaqir Haliti
41. Sonila Shaban Hagja (Hasanaj)
42. Floriana Myftar Lumeshi
43. Florimonda Myftar Lumeshi
44. Fatjona Myftar Lumeshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 486, datë 14.7.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “SHTIMI I SIPËRFAQES SË
VARREZAVE PUBLIKE TUFINË”,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë

22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shtimi i sipërfaqes së varrezave publike Tufinë”, Tiranë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 8 503 936 (tetë milionë e pesëqind e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 8 503 936 (tetë milionë e pesëqind e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren zyrtare.

6. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

7. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.



9. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Llogaritjet paraprake për pasuritë që preken nga zgjerimi i sipërfaqeve të varrezave publike Tufinë

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i pasurisë	Zona Kadast.	Nr. Pasurisë	Sip. Përgj. Tokë Bujqësore (m ²)	Sip. Tokë Bujqësore e prekur (m ²)	Çmimi Tokë Bujqësore lek/m ²	Vlera në lekë	Konfirmim i ZVRPP- Tiranë
1	Petrit Shyqyri Qefalia	"Arë"	3426	27/6	2900	2900	448	1,299,200	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
2	Bashkim Mexhid Kuka	"Arë"	3426	27/5	2500	2500	448	1,120,000	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
3	Qemal Abdulla Qefalia	"Arë"	3426	27/4	5200	5200	448	2,329,600	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
4	Shtet	"Arë"	3426	619	500	299	448	0	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
5	Shtet	"Arë"	3426	615	200	200	448	0	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
6	Shtet	"Arë"	3426	27/11	200	200	448	0	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
7	Qemal Abdulla Qefalia	"Arë"	3426	27/10	1770	1770	448	792,960	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
8	Qemal Abdulla Qefalia	"Arë"	3426	27/8	810	810	448	362,880	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
9	Shtet	"Arë"	3426	27/9	720	720	448	0	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
10	Dilaver Islam Dajti	"Arë"	3426	28	3000	2272	448	1,017,856	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
11	Petrit Shyqyri Qefalia	"Arë"	3426	27/2	3000	3000	448	1,344,000	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
12	Ramiz Osman Qefalia	"Arë"	3426	27/1	530	530	448	237,440	Shkr. nr.prot.35393/1, dt. 13.01.2017
Total								8,503,936	

1. Për tokën bujqësore, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.3.2.2016.

2. Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste janë bazuar në shkresën e ZVRPP-së, Tiranë, nr. Prot. 35393/1, datë 13.1.2017, protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. Prot. 1486, dt. 13.1.2017.

URDHËR

Nr. 73, datë 5.7.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave, Zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi, për trajtimin e praktikës nr. 3361 Prot., datë 13.6.2017, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me objekt detajimin e investimeve për vitin 2018 - 2019, për programin "Transporti Rrugor", sipas parashikimeve të legjislacionit buxhetor në fuqi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave, për çështjen e përcaktuar në pikën 1

(një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi, deri në shfuqizimin e tij.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Zëvendësministri i Ministrisë së Financave, z. Erjon Luçi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Helga Vukaj

VENDIM

Nr. 91, datë 4.7.2017

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2017, PËR OSHEE SHA

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, germat "a" dhe "e"; neni 75; nenit 110, pika 2 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009; si dhe nenit 14 dhe 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin



dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 të shoqërisë OSHEE sh.a., të përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi:

- “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a., në shkresën me nr. 23480 Prot, datë 14.10.2016, ka paraqitur pranë ERE-s një studim lidhur me “Planin ekonomik-financiar për vitin 2017”.

- Grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 62, datë 2.11.2016, të kryetarit të ERE-s, shqyrtoi aplikimin e dërguar nga kompania.

- Edhe mbas kërkesave të përsëritura të ERE-s, për plotësim dokumentacioni, është konstatuar paraqitje jo e plotë konform kërkesave të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, sipas nenit 11, pika 2, përkatësisht:

- Raport lidhur me zbatimin e planit të vitit paraardhës.

- Relacion shpjegues për investimet e planifikuara.

- Paraqitje e kërkesave të nenit 10 (Planet e investimeve për të licencuarit në veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike).

- Investimet janë paraqitur kryesisht me nocionet e buxhetimit dhe janë përdorur pak nocione teknike.

- Koha e paraqitjes e pamjaftueshme për një analizë teknike.

- Nevoja për saktësim të planit pas vendimit lidhur me tarifat 2017.

- Nevoja për saktësimin e dokumentacionit sipas procedurave.

- Nevoja për miratimin e një plani investimesh të bëshëm (fisible).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 për shoqërinë OSHEE sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin dhe personat e interesuar për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 92, datë 4.7.2017

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2017, PËR KESH SHA

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, pika “e”, nenit 109, pika 5; nenit 110, pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; gjithashtu dhe nenit 14 dhe neni 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; neneve 8; 11; 12; 13 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, për shoqërinë KESH sh.a., të përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

- Me anë të shkresave nr 773 Prot, datë 3.11.2016, dhe nr. 276 Prot. datë 30.3.2017, në zbatim të nenit 10 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, është kërkuar nga ERE paraqitja për miratim e planit të investimeve të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2017 sipas kërkesave të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.



- Grupi i punës, i ngritur me urdhër të kryetarit të ERE-s nr. 25, datë 11.5.2017, duke mbajtur në konsideratë shkresën nr. 635/5, datë 27.2.2017, të shoqërisë KESH sh.a., me të cilën është dërguar në ERE plani i investimeve të KESH sh.a. së bashku me shkresën nr. 578/1 Prot, datë 2.2.2017, të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, me të cilën kjo e fundit është shprehur për “Miratimin e programit ekonomik-financiar të KESH sh.a., për vitet 2017 - 2021”, mori në shqyrtim tabelën e “Planit të investimeve për shoqërinë KESH sh.a. për vitin 2017”.

- Gjatë shqyrtimit të këtij informacioni, grupi i punës konstatoi se ky informacion plotësonte një pjesë të kërkesave të përcaktuara në “Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e ERE-s, nr. 62, datë 15.9.2009.

1. Edhe pas kërkesave të përsëritura nga ana e ERE-s është konstatuar paraqitje jo e plotë e dokumentacionit, sipas kërkesave të përcaktuara në nenin 11, pika 2 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

2. Vërehen mangësi dhe në:

a) raportin lidhur me zbatimin e planit të vitit paraardhës (neni 7, pika 3);

b) relacionin shpjegues për investimet e planifikuara (neni 7, pika 1);

c) paraqitjen e kërkesave të nenit 8 (Plani i investimeve për të licencuarit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike).

3. Investimet janë paraqitur kryesisht me nocion buxhetimi e pak teknik.

4. Koha e paraqitjes e pamjaftueshme për një analizim teknik.

5. Nevoja për saktësim të planit pas vendimit lidhur me tarifat 2017.

6. Nevoja për saktësimin e dokumentacionit sipas procedurave.

7. Nevoja për miratimin e një plani investimesh fisibel.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “Planit të investimeve për kompaninë KESH sh.a., për vitin 2017”.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 93, datë 4.7.2017

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PPC ALBANIA” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “PPC Albania” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 72, datë 11.5.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “PPC Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “PPC Albania” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “PPC Albania” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5 (pesë)-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 94, datë 4.7.2017

MBI RINOVIMIN E LICENCËS NR. 176, SERIA T12 TË SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 e “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi

relacionin për rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 71, datë 11.5.2017, filloi procedurën për rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. ka plotësuar kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës nr. 176, seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë)-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 95, datë 4.7.2017

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
KUSHTET DHE PROCEDURAT E
VENDOSJES SË GJOBAVE DHE MASËN
KONKRETE PËR ÇDO SHKELJE NË
SEKTORIN E GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16, 106/2 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të saj dhe relacionin përkatës mbi miratimin e draftrregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror,

konstatoi se:

- Enti Rregullator, në mbështetje të nenit 106/2, të ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, miraton Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror.

- Me Vendimin me nr. 170, datë 31.10.2016, ERE filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Draftrregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror”.

- ERE, me shkresën nr. 722 Prot., datë 2.11.2016, dërgoi “Draftrregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”, për marrje mendimi pranë subjekteve MEI, Autoritetit të Konkurrencës, Albpetrol, Phoenix Petroleum dhe ANIO Oil & Gas sh.a.

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 369/1, datë 30.11.2016, është shprehur se “Draftrregullorja për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror” nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës.”

- MEI, me shkresën nr. 6596/1 Prot., datë 29.12.2016, ka përcjellë në ERE dakortësinë e saj

lidhur me “Draftrregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së masave administrative dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”.

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me korrespondencën elektronike datë 9.3.2017, protokolluar me tonën me nr. 220 Prot, datë 10.3.2017, ka përcjellë në ERE komentet mbi Draftrregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje në sektorin e gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
MBI KUSHTET DHE PROCEDURAT E
VENDOSJES SË GJOBAVE DHE MASËN
KONKRETE PËR ÇDO SHKELJE

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 106/2 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, ligjit 45/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative” dhe në përputhje me “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.



Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë të licencuarit në sektorin e gazit natyror, për të cilët ERE nis procedurën për vendosjen e gjobave për shkeljet e konstatuara sipas parashikimeve të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. ERE aplikon procedura të njëjta për të licencuarit në sektorin e gazit natyror në rastet e vendosjes së gjobave.

Neni 3 Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurat e aplikimit të gjobave, metodologjinë e konstatimit e përcaktimit të tyre, si dhe masat e lehtësimit që aplikohen për gjobat e vendosura për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në rastet e shkeljeve të ndëshkueshme me gjobë nga ERE.

Neni 4 Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. Ligj do të thotë ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.
2. Bordi i ERE-s do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara në ligj.
3. ERE do të thotë Enti Rregullator i Energjisë.
4. Licencë do të thotë një e drejtë e dhënë nga ERE-ja një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror në përputhje me dispozitat që kërkohen nga ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe procedurave të licencimit të ERE-s.
5. I licencuar do të thotë një person i pajisur me një licencë të dhënë nga ERE për të operuar në sektorin e gazit natyror.
6. Procedurë do të thotë tërësi e veprimeve të ERE-s për marrjen e masave administrative të vendosjes dhe reduktimit të gjobave, për të licencuarit në sektorin e gazit natyror.
7. Subjekt i interesuar do të thotë çdo i licencuar apo çdo person tjetër që merr shërbim apo kryen aktivitet në sektorin e gazit natyror.

8. Të ardhurat vjetore do të thotë totali i të ardhurave të gjeneruara nga shitja e të mirave të siguruara nga aktiviteti në sektorin e gazit natyror apo shërbimeve të kryera gjatë një viti financiar nga një subjekt tregtar.

9. Xhiro mesatare ditore do të thotë të ardhurat mesatare të siguruara në ditë nga shitja dhe/ose ofrimi i shërbimeve në sektorin e gazit natyror.

10. Vlera fillestare e gjobës do të quhet vlera e përcaktuar nga bordi i ERE-s për efekt të llogaritjes së vlerës përfundimtare të gjobës, e cila llogaritet sipas aneksit nr. 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

11. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimin e parashikuar në ligjin 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

PJESA E DYTË DISPOZITA TË POSAÇME

Neni 5 Gjobat

1. Çdo i licencuar mund të jetë subjekt i ndëshkimit nga ERE për një ose më shumë nga shkeljet e kryera prej tij, si më poshtë:

a) Dënohen nga ERE me gjobë nga 0,1% deri në 0,5% të të ardhurave vjetore të vitit paraardhës të të licencuarit shkeljet e kryera nga subjektet e licencuara:

i) Kryerja e një veprimtarie në sektorin e gazit natyror pa licencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, sikurse parashikohet në pikën 1, të nenit 22 të ligjit.

ii) Veprimet e kryera nga subjektet që i nënshtrohen zbatimit të ligjit, të realizuara në kundërshtim me kushtet e parashikuara në licencë, sipas parashikimeve të neneve 50, pika 4, 75, 85, pika 4, si dhe veprimet në kundërshtim me shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “p”, “g” dhe “gj”, të pikës 1, të nenit 41 të ligjit.

iii) Refuzimi i paraqitjes së të dhënave, informacioneve, raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre, ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licencuari, në kundërshtim me nenet 17, pika 1/a, 37, pika 6, 39, pika 2, 40, pika 2, 53, pikat 5 e 6, 63, pika 6, 66, 73, 87, pika 4, 92, pika 3, 95, pika 5 dhe 97, pikat 1, 2, 5, 7 e 9 të ligjit.

iv) Moszbatimi i detyrimeve lidhur me llogaritjen dhe aplikimin e kostove dhe tarifave, sikurse kërkohet në nenet 17, pika 1, shkronja “dh”, 33, pikat 1-7, 90, pikat 10 e 11 dhe 56, pika 4 të ligjit.



v) Moszbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, të vendosura sipas kërkesave të neneve 92, pika 11, dhe 93, pikat 2 e 4 të ligjit.

vi) Moszbatimi i detyrimeve për mbajtjen e llogarive të ndara, sipas neneve 30, 75, 80, pika 6, dhe 85, pika 6 të ligjit.

vii) Moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesin e palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet në nenet 42, pikat 1-3, 54, 64 dhe 71 të ligjit.

viii) Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara, si dhe vendosja e kushteve shtesë në kontratën e furnizimit apo mosnjofitimi në kundërshtim me nenet 76, pika 5, dhe 90, pika 4 të ligjit.

ix) Mospublikimi i informacionit për tarifatat dhe kushtet e përgjithshme të aksesit në rrjet, si dhe përdorimi i shërbimeve të rrjetit, sikurse përcaktohet në nenin 33, pika 8 të ligjit.

x) Mosparaqitja e programeve të investimeve dhe/ose moskryerja e investimeve të planifikuara, sipas kërkesave të neneve 46 dhe 56 të ligjit, si dhe rregullores përkatëse të ERE-s.

xi) Shkelja e kushteve dhe kërkesave të cilësisë së furnizimit, të miratuara nga ERE, parashikuar në nenin 89, pika 4 të ligjit.

xii) Moszbatimi i vendimeve të ERE-s.

xiii) Mosrespektimi i kërkesave të neneve 39, pikat 4 e 6 dhe 60, shkronja “ç” të ligjit.

xiv) Mosmarrja e masave për hartimin e programit të përputhshmërisë dhe emërimin e zyrtarit të përputhshmërisë, sipas kërkesave të neneve 47, pika 1, 51, pika 5 dhe 80, pika 7 të ligjit.

xv) Mosrespektimi i përgjegjësive të ngarkuara për operatorin e sistemit të depozitës dhe GNL-së, sipas parashikimeve të neneve 61 dhe 69 të ligjit.

xvi) Aplikimi i kushteve shtesë në kontratat që janë drejt përfundimit, në kundërshtim me nenin 76, pika 5 të ligjit.

xvii) Mosnjofitimi i klientëve nga furnizuesi i mundësisë së fundit, sipas kërkesave të nenit 90, pika 4 të ligjit.

xviii) Mosrespektimi i kërkesave të nenit 77 të ligjit në lidhje me ruajtjen e të dhënave.

xix) Mosrespektimi i detyrimit për të lidhur kontratë, sipas nenit 96, pika 8 të ligjit për klientët që plotësojnë kushtet sipas pikës 1 të këtij neni.

b) ERE duke vepruar sipas neneve 39(7) dhe 106(2) të ligjit mund të vendosë masa administrative deri në 10% të të ardhurave vjetore të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, mbi

Operatorin e Sistemit të Transmetimit, ose mbi 10% të të ardhurave vjetore të kompanive vertikalisht të integruara, mbi kompanitë vertikalisht të integruara për mospërputhjen me detyrimet e tyre respektive në lidhje me veçimin dhe/ose pavarësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në përputhje me nenin 36 të ligjit.

c) ERE aplikon gjobë progresive për çdo ditë shkelje ndaj subjekteve të ligjit për rastet e mëposhtme:

i) Kur i licencuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korigjimin e një shkeljeje brenda afateve të përcaktuara prej saj. Në këtë rast, i licencuari dënohet me gjobë në masën 0,1% të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonese nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s.

ii) Kur i licencuari nuk përmbush detyrimin e pagesës rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me gjobë në masën 0,2% të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonese nga dita e përcaktuar për pagesën.

2. Masat e gjobës do të përcaktohen nga ERE në përputhje me aneksin 1 të kësaj rregulloreje brenda kufijve si më poshtë:

a) Jo më shumë se 0,5% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit.

b) Jo më pak se 0,1% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit.

c) Jo më shumë se 10% të të ardhurave vjetore nga viti financiar i kaluar i Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose kompanitë vertikalisht të integruara.

3. Gjoha progresive për çdo ditë vonese nuk mund të kalojë vetë vlerën e gjobës fillestare ose vlerën maksimale të përcaktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni.

4. Vlera përfundimtare e gjobës do të përcaktohet si zbritje e vlerës fillestare të gjobës me vlerën e kushteve lehtësuese, nëse kjo e fundit mund të aplikohet.

Neni 6

Fillimi i hetimit

1. Procedurat e vendosjes dhe ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”. ERE mund të fillojë një hetim për vendosje gjobe në rastet kur:

a) ka marrë kryesisht dijeni për një shkelje;



b) vihet në dijeni nga një i licencuar tjetër apo nga një subjekt i interesuar për një shkelje;

c) ka dyshimin e arsyeshëm se kushtet e licencës janë shkelur.

2. Në çdo rast, fillimi i hetimit vendoset me urdhër të kryetarit të ERE-s apo vendim të bordit të ERE-s.

Neni 7

Shqyrtimi fillestar

1. ERE nuk mund të vendosë për fillimin e një procedure për vendosje gjobe nëse shkelja e pretenduar apo konstatuar pas hetimit rezulton se ka më shumë se 6 muaj që ka ndodhur.

2. Në çdo rast që stafi teknik, i cili ka kryer hetimin, konstaton një nga shkeljet e parashikuara në nenin 5, do të përgatisë një informacion/relacion të detajuar mbi shkeljen/et e konstatuara dhe propozimin për fillimin e procedurës për vendosje gjobe ndaj të licencuarit.

3. Vendimi i Bordit të ERE-s për të filluar procedurën e vendosjes së gjobës një të licencuari do t'i njoftohet të licencuarit nga ERE brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit të bordit të ERE-s.

4. Njoftimi për vendosjen e gjobës do të përmbajë:

- shkeljen e konstatuar;
- masën e gjobës së propozuar;
- identitetin e të licencuarit;

- dokumentacionin provues ku mbështetet vendosja e gjobës;

- të drejtën e të licencuarit për të kthyer përgjigje brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja dijeni, si dhe paraqitjen e argumenteve dhe çdo dokumentacioni shkresor mbështetës në funksion të përgjigjes së tyre apo për qëllime të aplikimit të rrethanave lehtësuese. I licencuari ka të drejtë që brenda këtij afati të kërkojë zhvillimin e një seance dëgjimore për të bërë sqarimet e duhura.

5. Në çdo fazë të një procedimi për vendosje gjobe, ERE mund të kryejë seanca dëgjimore me të licencuarin dhe subjektin që ka kërkuar kryerjen e hetimit ose të kërkojë dokumente të tjera të nevojshme për qëllime të procedurës së nisur. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet brenda 30 ditëve nga data e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj pas kryerjes së kësaj kundërvajtjeje.

Neni 8

Përcaktimi i vlerës fillestare të gjobës

ERE do të përcaktojë vlerën fillestare të gjobës brenda kufirit maksimal dhe minimal të vendosur në nenin 106, pika 1 të ligjit. Rëndësia e shkeljes do përcaktohet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
- b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht më parë;
- c) rëndësinë e kundërvajtjes;
- d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi;
- e) nëse kundërvajtësi është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje.

Neni 9

Rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të gjobës, rrethanat e kryerjes së shkeljes do të konsiderohen të lehta, mesatare apo të rënda.

2. Për përcaktimin e niveleve të rrethanave do të merren për bazë kriteret e mëposhtme:

- a) pozicioni hierarkik në kompani i personit që ka kryer shkeljen;
- b) mungesa e modeleve organizative dhe të rregullave të menaxhimit korrekt me qëllim parandalimin e kryerjes së shkeljes;
- c) përpjekjet për të fshehur shkeljen.

Neni 10

I licencuari me precedentë dënimi administrativ

Nëse i licencuari është dënuar më parë për shkelje të legjislacionit të sektorit të energjisë, është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje administrative, gjoba përfundimtare e parashikuar për llojin e kundërvajtjes do të rritet në masën 10% të vlerës së gjobës minimale të kriterit përkatës të parashikuar në aneksin 1.

Neni 11

Rëndësia e shkeljes së kryer

1. Për efekt të llogaritjes së rëndësisë të shkeljes së kryer, ato do të konsiderohen të rëndësisë së ulët, mesatare apo të lartë.

2. Për përcaktimin e nivelit të rëndësisë së shkeljes së kryer do të merret për bazë:

- a) Përfitimi financiar i realizuar nga i licencuari, i cili do të llogaritet mbi bazën e raportit të të



ardhurave të përfituara me të ardhurat vjetore të vitit paraardhës të të licencuarit.

b) Dëmi i shkaktuar në palë të treta.

Neni 12

Pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të gjobës, pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i të licencuarit do konsiderohen të nivelit të ulët, mesatar apo të lartë.

2. Për përcaktimin e niveleve të pasojave do të merren për bazë kriteret e mëposhtme:

a) dëmi i shkaktuar apo rritja e kostove të shkaktuara konsumatorëve apo pjesëmarrësve në treg;

b) numri i klientëve të përfshirë;

c) rritja e dominancës në treg të të licencuarit;

d) pengimi i punës së ERE-s në kryerjen e funksioneve të veta ligjore për monitorimin dhe kontrollimin e të licencuarit.

Neni 13

Lehtësimi nga gjoba

1. ERE do të konsiderojë se i licencuari plotëson kushtet për lehtësimin në vlerën e gjobës kur gjatë hetimit rezulton se ekzistojnë një ose të gjitha rrethanat si më poshtë:

a) Në masën 50%, në rastet kur shkelja për të cilën parashikohet gjoba është njoftuar nga vetë i licencuari.

b) Në masën 1/3, në rastet kur i licencuari bashkëpunon në mënyrë aktive në procesin e hetimit administrativ të ERE-s për konstatimin e shkeljes në fjalë.

c) Në masën 40%, në rastet kur i licencuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja, përpara ose gjatë konstatimit të shkeljes nga ERE.

d) Do të konsiderohen veprime që çojnë në përmirësimin e tregut veprimet të cilat, pavarësisht shkeljes, kanë ndikuar në përmirësimin e standardeve të shërbimit, konkurrencës, eficiencën në treg etj.

Neni 14

Propozimi përfundimtar

1. Pasi ka marrë përgjigjen me shkrim nga i licencuari në përputhje me nenin 7, paragrafi 4, pika 5 dhe/ose sipas seancës dëgjimore në përputhje me nenin 7, paragrafi 5 i kësaj rregulloreje, personat e autorizuar nga stafi i ERE-s duhet të rishikojnë përgjigjen e të licencuarit dhe çdo dokument, informacion të mbledhur gjatë procedurës, jo më vonë se 5 ditë pune pas marrjes së përgjigjes së të licencuarit, ose sipas rastit, seancës së fundit dëgjimore.

2. Bordi i ERE-s mund të vendosë të mos gjobisë të licencuarin sipas propozimit të stafit teknik nëse konstaton se faktet e paraqitura nuk provojnë shkeljen.

Neni 15

Vendimi i bordit

1. Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas dispozitave të mësipërme të kësaj rregulloreje dhe pasi është njohur me përgjigjen e të licencuarit, bordi i ERE-s do të vendosë për ndëshkimin ose jo të të licencuarit dhe vlerën përkatëse të gjobës.

2. Në përfundim të një procedure për vendosjen e gjobës një subjekti të licencuar, ERE do të njoftojë të licencuarin mbi përfundimin e procedurës së nisur ndaj tij, si dhe do t'i dërgojë një kopje të vendimit të bordit brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit.

3. Gjoba e vendosur nga bordi i ERE-s përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 16

Apelimi i vendimit

Kundër vendimit të bordit të komisionerëve për vendosje të gjobës, i licencuari mund të bëjë ankim në përputhje me ligjin. Ankimi ndaj vendimit të ERE-s për heqjen e licencës apo miratimit për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje administrative bëhet sipas ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".



PJESA E TRETË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17
Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të bordit të ERE-s në përputhje me “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore dhe pjesët përbërëse të saj hyjnë në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ANEKSI 1

Tabela për llogaritjen e vlerës përfundimtare të gjobës

Faza I; Fiksimi i vlerës fillestare të gjobës në varësi të rëndësisë së shkeljes			
Kriteret e rëndësisë së shkeljes			
1. Kohëzgjatja e shkeljes dhe shtrirja territoriale e saj	25%	E shkurtër	2%
		E mesme	6%
		E gjatë	12%
		Lokale	2%
		Rajonale	4%
2. Ndikimi i shkeljes në funksionimin e tregut të energjisë	25%	Kombëtare	13%
		I ulët	4%
		I mesëm	12%
3. Përfitimi ekonomik i realizuar nga i licencuari si pasojë e shkeljes	25%	I lartë	25%
		I ulët	4%
		Mesatar	12%
4. Lloji i fajësisë së të licencuarit	25%	I lartë	25%
		Dashje	25%
		Pakujdesia	8%
Faza II: Llogaritja e gjobës përfundimtare do bëhet sipas formulës: $G_j = VFG_j - KL$ Ku $G_j =$ Gjoba $VFG_j =$ Vlera fillestare $KL =$ Kushtet lehtësuese			
Kushtet lehtësuese	Shkelja për të cilën parashikohet gjobë deklarohet nga vetë i licencuari		50%
	2. I licencuari bashkëpunon në mënyrë efikase në procesin e investigimit të ERE-s për shkeljen në fjalë		33%
	3. I licencuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja.		40%



VENDIM
Nr. 96, datë 4.7.2017

MBI SHTYRJEN E AFATIT TË
VENDIMIT TË ERE-S NR. 115, DATË
7.8.2016, “MBI PËRCAKTIMIN E
FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË
FUNDIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 2 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit nr. 449, datë 15.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike” dhe nenit 8 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, “Mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”.

- Në pjesën III, të VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike.” Parashikohet se deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas këtij vendimi, ERE cakton përkohësisht furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit.

- Me VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, janë miratuar “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Në VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, është parashikuar se: detyrimi i shërbimit publik përfshin ndër të tjerë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., ku kjo e fundit do të sigurojë blerjen e energjisë elektrike për qëllime të shërbimit universal nga KESH sh.a.

- Me vendimin nr. 195, datë 30.12.2016, bordi i ERE-s vendosi mbi shtyrjen e afatit të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, mbi përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike deri në 30 qershor 2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën 1 të vendimit të ERE-s nr. 115, datë 7.8.2016, deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit sipas VKM-së nr. 449, datë 15.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 97, datë 4.7.2017

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT,
MODIFIKIMIT, TRANSFERIMIT OSE
HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN
E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 13 dhe 24 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike, mbi miratimin e Draftregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e bordit nr. 152, datë 30.9.2016, filloi procedurat “Për shqyrtimin dhe miratimin e “Draftregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- ERE, me shkresën nr. 26/38 Prot., datë 4.10.2016, publikoi për 3 ditë me radhë në



median e shkruar njoftimin për fillimin e procedurave “Për shqyrtimin dhe miratimin e draftrregullore për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, duke filluar nga data 6 tetor 2016. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve.

- ERE, me shkresën nr. 715 Prot., në datën 7.10.2016, dërgoi “Draftrregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, për marrje mendimi, pranë subjekteve: MEI, Autoriteti i Konkurrencës, Albpetrol dhe ISHTI.

- ISHTI, me shkresën nr. 9345/1 Prot., datë 13.10.2016, është shprehur se draftrregullorja siguron një trajtim të barabartë dhe transparent për të gjitha subjektet që do të pajisen me licencë në përputhje me dispozitat e ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, për të siguruar një treg konkurrues që garanton furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt, që kujdeset për mbrojtjen e mjedisit dhe aplikon procedura të njëjta për të gjithë të licencuarit.

- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 337/1 Prot., datë 24.10.2016, është shprehur se “Draftrregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

- Gjithashtu edhe ENC, me anë të komunikimit elektronik, ka përcjellë propozimet në lidhje me “Draftrregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, të cilat, pasi janë shqyrtuar rast pas rasti, janë reflektuar në këtë draft.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORJA PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN OSE HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Autoriteti**

Kjo rregullore është përgatitur në përputhje me nenin 16, pika 11, dhe nenin 24 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 2 **Qëllimi i rregullores**

Kjo rregullore përcakton procedurat e licencimit për:

1. Kryerjen e aktiviteteve sikurse janë përcaktuar në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, duke specifikuar termat dhe kushtet për dhënie, ndryshimin e një licence, si dhe autoritetin e ERE-s për përcaktimin e pagesave për t'u kryer për çdo lloj aplikimi për licencë.

2. Kushtet për dhënie, heqjen, modifikimin, transferimin e një licence në përputhje me nenin 27, 28 29 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 3 **Përkufizime**

Përkufizimet e termave të përcaktuara në:

(i) ligjin “Për sektorin e gazit natyror” nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”;

(ii) ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”;

(iii) rregullat e organizimit dhe funksionimit të ERE-s janë të përfshira në këtë dokument për të gjitha qëllimet. Në këto rregulla, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:



“Aplikues” do të thotë çdo person i cili aplikon për një procedim nga procedurat sipas kësaj rregulloreje.

“Aplikim” do të thotë depozitimi i dokumenteve për një nga procedurat e parashikuara në këtë rregullore, sikurse është shpjeguar në nenet 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje.

“Bordi i ERE-s” ose “bordi” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, që vepron në bazë të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

“Garanci e performancës” do të thotë një angazhim nga shoqëria mëmë e aplikantit ose të licencuarit për të siguruar përmbushjen në mënyrë të ndershme dhe të besueshme prej këtij aplikanti ose të licencuarit të të gjithë termave dhe kushteve të licencës. Në rastet kur nuk ka shoqëri mëmë, atëherë çdo pronar që zotëron 5% ose më shumë të aksioneve ose të kapitalit të tij në këtë aplikim, ose licencë do të lëshojë një garanci performance të tillë.

“Garanci financiare” do të thotë një garanci nga një bankë ose persona të tjerë përgjegjës, të pranueshëm për ERE-n për të mbuluar dhe siguruar përmbushjen në mënyrë të ndershme dhe të besueshme të detyrimeve financiare të aplikantit ose të licencuarit, sikurse mundet të jetë rasti, sipas termave dhe kushteve të licencës.

“Gaz natyror” është gazi metan, përfshirë gazin shoqëruar, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë në kushte atmosferike normale, i cili përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

“Licencë” do të thotë një e drejtë e dhënë nga ERE për ushtrimin e një veprimtarie në përputhje me ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

“I licencuar” do të thotë personi i pajisur me një licencë dhënë nga ERE për të kryer aktivitete në sektorin e gazit natyror në përputhje me dispozitat e ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

“OST” do të thotë Operator i Sistemit të Transmetimit të Gazit.

“OSSH” do të thotë Operator i Sistemit të Shpërndarjes së Gazit.

“Person” do të thotë çdo person juridik.

“Përfaqësues zyrtar” do të thotë personi i emëruar nga organet drejtuese të personit juridik, të autorizuar sipas legjisllacionit shqiptar në fuqi, për të përfaqësuar aplikuesin ose të licencuarin për të gjithë qëllimet, sikurse është përcaktuar në këtë rregullore.

“Sistem” do të thotë çdo rrjet transmetimi, rrjet shpërndarjeje, impiant GNL ose hapësirë depozitimi, në pronësi ose përdorim/operim nga një i licencuar, përfshirë *linepack* së bashku me instalimet dhe funksionet e tij që sigurojnë shërbime ndihmëse, si dhe ato që janë të nevojshme për mundësimin e hyrjes në rrjetet e transmetimit, shpërndarjes dhe impiantet e GNL-së.

“Rregullore” do të thotë ky dokument i titulluar “Rregullat dhe kërkesat për dhënie, modifikimin, transferimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

“Tarifë aplikimi” është pagesa përkatëse, e vendosur nga bordi i ERE-s në përputhje me nenin 14 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, që çdo person ose i licencuar duhet kryejë ndaj ERE-s në përputhje me këtë rregullore për trajtimin e kërkesës së paraqitur për licencim, ndryshim, transferim licence.

Neni 4

Aktivitetet e licencuara

1. ERE mund të japë licenca për veprimtaritë e përcaktuara nga ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” sikurse vijojnë:

- a) transmetim të gazit natyror;
- b) shpërndarje të gazit natyror;
- c) furnizim të gazit natyror (shitje me pakicë);
- ç) tregtim të gazit natyror (shitje me shumicë);
- d) operim të hapësirave të depozitimit të gazit natyror;
- dh) operim në impiantet e GNL-së;
- e) funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.

2. Ushtrimi i çdo aktiviteti të sipërpërmendur kërkon licencë të veçantë.

3. Licencat do të lëshohen nga ERE në përputhje me këtë rregullore rast pas rasti dhe do të jenë të mbështetura në licencat model përkatëse të miratuara nga ERE.



Neni 5

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së një licence të lëshuar sipas kësaj rregulloreje për transmetim, shpërndarje, depozitim dhe GNL prej ERE në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje do të jetë për një periudhë prej 30 vitesh. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së një licencë për furnizim dhe tregtim operimi në hapësirat e gazit natyror, funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror do të jetë për një periudhë prej 10 vitesh.

KREU II

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR LICENCË

Neni 6

E drejta për të aplikuar për licencë

Ka të drejtë të aplikojë për një licencë të lëshuar nga ERE çdo person që ka vendqëndrimin e tij në Shqipëri dhe me objekt të veprimtarisë aktivitetin e kërkuar për licencim. Çdo person i huaj duhet të krijojë një shoqëri tregtare sipas legjislacionit në fuqi me objekt veprimtarie aktivitetin e kërkuar për licencim nga ERE për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës.

Neni 7

Përfaqësuesi i aplikantit

1. Përfaqësuesi zyrtar do të përfaqësojë aplikantin përpara ERE-s për çdo çështje që ka të bëjë me aplikimin ose licencën që mundet të lëshohet.

2. Përfaqësuesi zyrtar do t'i paraqesë në ERE prokurën, vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër të nënshkruar ose miratuar nga aplikanti për caktimin e përfaqësuesit zyrtar si të autorizuarin e vet.

3. Përfaqësuesi zyrtar do t'i paraqesë ERE-s një vendim të shoqërisë ose çdo dokument tjetër të miratuar në mënyrë të rregullt nga aplikanti që autorizon këtë përfaqësues të depozitojë sipas rastit kërkesën për licencë ose modifikim, apo transferimin e saj.

4. Përfaqësuesi zyrtar duhet:

a) Të paraqesë aplikimin për licencë së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas neneve 8, 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje.

b) Të paraqesë të dhëna dhe informacion shtesë të kërkuar nga ERE gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit për licencë.

c) Të përfaqësojë aplikantin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me aplikimin.

d) Të përfaqësojë të licencuarin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me çdo licencë të lëshuar në vijim të një aplikimi brenda kufijve të kompetencave të dhëna në autorizimin e depozituar në ERE.

5. Aplikanti ose i licencuari, kushdo qoftë, mundet të ndërrojë përfaqësuesin e tyre zyrtar duke paraqitur menjëherë një njoftim me shkrim pranë ERE-s për këtë ndryshim, të shoqëruar me prokurën ose autorizimin e organeve vendimmarrëse të shoqërisë për këtë qëllim.

Neni 8

Paraqitja e një aplikimi për licencë

1. Aplikimi konsiston në formatin e aplikimit dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje të plotësuar në mënyrë të rregullt nga aplikanti.

2. Aplikuesi do t'i paguajë ERE-s tarifën e aplikimit në fuqi në kohën kur aplikimi paraqitet.

3. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikanti do të jetë origjinal dhe në gjuhën shqipe dhe nëse është kopjuar ose përkthyer prej origjinalit, atëherë dokumentet e kopjuara ose të përkthyer duhet të jenë të noterizuara.

4. Certifikatat dhe deklaratimet që mbështesin aplikimin duhet të jenë lëshuar jo më herët se 1 muaj prej datës së paraqitjes së aplikimit.

5. Aplikanti do të sigurojë që i gjithë dokumentacioni teknik i paraqitur së bashku me aplikimin e tij është përgatitur dhe nënshkruar nga ekspertë profesionistë të licencuar në fushën përkatëse. ERE mundet të kërkojë që këta ekspertë ta vërtetojnë ekspertizën e tyre.

6. Çdo Aplikim i shoqëruar nga dokumentacioni përkatës do të paraqitet në dy kopje:

a) Një kopje origjinale ose fotokopje e noterizuar sikurse përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

b) Një fotokopje e printuar dhe një në format elektronik e të gjithë dokumentacionit sikurse përcaktuar në këtë rregullore.

Neni 9

Format dhe dokumentacioni për aplikim

1. Forma e aplikimit (për t'u plotësuar nga aplikanti)



Një Aplikim për një licencë do të përbëhet nga:

a) Tipi i Aplikimit

1	Lloji i aplikimit	<input type="checkbox"/> Licencim	<input type="checkbox"/> Transferim	<input type="checkbox"/> Ndryshim
2	Tipi i licencës	<input type="checkbox"/> Transmetim i gazit natyror <input type="checkbox"/> Shpërndarje e gazit natyror <input type="checkbox"/> Furnizim i gazit natyror (shitje me pakicë) <input type="checkbox"/> Tregtim të gazit natyror (shitje me shumicë) <input type="checkbox"/> Operim i hapësirave të depozitimit të gazit natyror <input type="checkbox"/> Operim i impianteve të GNL-së		

(Shënim: Vendosni X në kutinë përkatëse)

b. Informacion i përgjithshëm për aplikantin (për t'u plotësuar nga aplikanti)

1	Emri i aplikantit		
	Numri i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit		
2	Zyra Qendrore e Shoqërisë	Adresa	
		Celular	
		Tel/Fax	
		Email	
3	Përfaqësuesi zyrtar	Emri	
		Pozicioni	
		Adresa	
		Cel	
		Tel/Fax	
		Email	

c. Të dhëna mbi aplikantin (për t'u plotësuar nga aplikanti)

1	Unë, aplikanti, deklaroj se: (a) Aplikantit nuk i është hequr asnjëherë ndonjë licencë e akorduar për gazin natyror ose (b) aplikantit nuk i është refuzuar asnjëherë ndonjë aplikim për licencë për gazin natyror, në Shqipëri ose vende të tjera Nëse përgjigja e ndonjërës prej pyetjeve (1.a) ose (1.b) është JO, atëherë aplikanti duhet të bashkëngjisë një shpjegim të plotë.	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
2	Unë, Përfaqësuesi zyrtar, deklaroj në emër të aplikantit se aplikanti është në dijeni të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi në sektorin e gazit natyror dhe paraqes angazhimin e aplikantit për zbatimin korrekt të tyre.	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
3	A është aplikanti i angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër tregtar në Shqipëri ose vend tjetër? Nëse përgjigja e pyetjes 3 është PO, atëherë aplikanti duhet të bashkëngjisë shpjegime shtesë.	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>



d) Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor:

i) Akti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit dhe statuti e akti i themelimit shoqërisë tregtare.

ii) Vërtetim nga organet kompetente që ndaj personit juridik apo personave dhe drejtuesve kryesorë të shoqërisë tregtare nuk ka një vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.

iii) Në rastin e subjekteve me nënshtetësi të huaj duhet të vërtetohet rezidenca shqiptare e përfaqësuesit të shoqërisë dhe dëshmi penaliteti.

iv) Struktura organizative dhe funksionimi administrativ i shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin është kërkuar licenca).

v) Me përjashtim të aplikimit për licencë të furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç), dhe operimit të tregut marrëveshja dhe leja e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Identiteti i të gjithë personave që kanë interes pronësor tek aplikanti më të madh dhe të barabartë me 5%.

vi) Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qira ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisore sipas rastit për aktivitetet, ushtrimi i të cilave kryhet me asetet përkatëse.

e) Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale.

i) Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej aplikantit.

ii) Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tre viteve të fundit që paraprijnë paraqitjen e aplikimit.

iii) Garancinë e përshtatshme financiare (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) dhe garancinë e performancës që sigurojnë aftësinë e aplikantit për të përmbushur të gjitha detyrimet e tij nën licencën e kërkuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar; largimin përfundimtar të plotë ose të pjesshëm të pajisjeve dhe/ose infrastrukturës dhe rehabilitimin e mjedisit, si dhe mbështetjen menaxheriale, operacionale dhe financiare prej pronarëve të aplikantit.

iv) Me përjashtim të rastit të furnizimit (neni 4.1.c) dhe rastit të tregtimit (neni 4.1.ç), një certifikate sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësive për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave, ose për humbjen, ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD. Kjo politikë ose këto politika sigurie do të jenë dhe qëndrojnë në fuqi dhe me efekt të plotë për të gjithë kohëzgjatjen e licencës së kërkuar. Për më tepër, i licencuari do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim që do të mund të ndodhë prej, ose të lidhet me, ose të rezultojë prej aktiviteteve të kryera gjatë kohëzgjatjes së licencës.

v) Vërtetimin e kryerjes së pagesës ndaj ERE-s të tarifës së aplikimit në fuqi në momentin e paraqitjes së aplikimit.

vi) Një plan biznesi, i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve, përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve.

vii) Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, ai duhet të informojë ERE-n për këtë synim dhe të japë një garanci të performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi.

2. Dokumente specifike për llojin e licencës.

Në varësi të tipit të licencës, aplikanti do të paraqesë në ERE dokumentet që vijojnë:

a. Licenca për transmetimin e gazit natyror;

a.1 Subjekti që aplikon për një licencë në transmetimin e gazit natyror, duhet që më parë të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 37 të ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

a.2 Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i) Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë hartën topografike për territorin ku do të ushtrojë aktivitetin.

ii) Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (*in take*) në sistem dhe të daljes (*off take*) prej sistemit dhe ndërlihdjet e tij me rrjete të tjera të



transmetimit dhe shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimit dhe terminalët e GNL-së.

iii) Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.

iv) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.

v) Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e aplikantit.

vi) Kategoritë dhe lista e konsumatorëve, si dhe livrimet e parashikuara.

vii) Vendndodhjet e matësve dhe specifikimet.

viii) Vendndodhjet e kontrollit të cilësisë së gazit.

ix) Dëshmi të kontratave/angazhimeve për transportin e gazit.

x) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta, sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".

xi) Lidhjet ndërkufitare dhe parametrat e operimit në vendet fqinje.

xii) Marrëveshjet operationale të balancimit.

xiii) Burimi i synuar dhe procedura e prokurimit të gazit natyror të nevojshëm për balancimin e sistemit të transmetimit.

xiv) Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt.

xv) Punët e aplikantit për (a) zgjidhjen teknike të propozuar (b) vlerësimin e ndikimit mjedisor (c) vlerësimin e kostos (d) parashikimet ekonomike, duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e transmetimit të gazit natyror, të përgatitura nga një shoqëri e specializuar inxhinierike.

xvi) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.

xvii) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të sistemit të transmetimit për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

xviii) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit.

b) Licenca për shpërndarjen e gazit natyror:

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i) Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë hartën topografike.

ii) Zonën gjeografike të mbuluar nga aplikimi.

iii) Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (*in take*) në sistem dhe të daljes (*off take*) prej sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjetet e tjera të transmetimit dhe shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimit dhe terminalët e GNL-së.

iv) Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.

v) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.

vi) Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e aplikantit.

vii) Kategoritë e konsumatorëve dhe livrimet e projektuara.

viii) Vendndodhjet e matësve dhe specifikimet.

ix) Planet e aromatizimit përfshirë vendndodhjet.

x) Dëshmi të kontratave/angazhimeve.

xi) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrjen e palëve të treta, sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".

xii) Lidhjet ndërrajonale dhe parametrat e operimit të OSSH-së fqinje nëse është e përshtatshme.

xiii) Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt nëse është e përshtatshme.

xiv) Punët e aplikantit për (a) zgjidhjen teknike të propozuar (b) vlerësimin e ndikimit mjedisor (c) vlerësimin e kostos (d) parashikimet ekonomike, duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e shpërndarjes të gazit natyror, të përgatitura nga një firmë e specializuar inxhinierike.

xv) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.

xvi) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të sistemit të shpërndarjes për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi.



xvii) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes.

xviii) Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t'u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

c) Licenca për operimin e impianteve të Gazit Natyror të Lëngëzuar (GNL):

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i) Tipi i impiantit të rigazifikimit.

ii) Hartat dhe vizatimet që tregojnë vendndodhjen e instalimeve në tokë dhe në det dhe pikën(at) e lidhjes me tubacionet tokësore të transmetimit, përfshirë hapësirat e magazinimit që lidhen me operacionet e GNL-së.

iii) Kapacitetin maksimal teknik, të kontraktuar dhe të disponueshëm në pikën e marrjes (*off take*) prej/për në terminal.

iv) Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.

v) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe matjes dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.

vi) Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e aplikantit.

vii) Programet e synuara të furnizimit dhe madhësia e anijeve cisternë të GNL-së.

viii) Madhësia e rezervuarëve të depozitimit.

ix) Burimet e furnizimit.

x) Kategoritë dhe lista e konsumatorëve të pritshëm, si dhe livrimet e projektuara.

xi) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta, sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".

xii) Punët e aplikantit për (a) zgjidhjen teknike të propozuar (b) vlerësimin e ndikimit mjedisor (c) vlerësimin e kostos (d) parashikimet ekonomike, duke përfshirë mënyrat financimit, të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e GNL-së, të përgatitura nga një shoqëri e specializuar dhe e licencuar për këto shërbime.

xiii) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jetëgjatësia e pritshme e projektit.

xiv) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të

impiantit të GNL-së për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të licencës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

xv) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së impiantit të GNL-së.

d) Licenca për operimin e hapësirave të depozitimit të gazit natyror:

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i) Vendndodhjen gjeografike të hapësirës së depozitimit nëntokësor dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë një hartë topografike.

ii) Përshkrim të kushteve gjeologjike të hapësirës depozituese nëntokësore.

iii) Volumi maksimal i depozitueshëm dhe gazi i vet i nevojshëm.

iv) Kërkesat minimale të cilësisë që duhet të plotësojë gazi që do të magazinohet.

v) Profili i debiteve të rilëvrimit të gazit natyror.

vi) Presioni maksimal i rezervuarit nëntokësor.

vii) Numri i puseve dhe debitet maksimale të tyre të injektimit dhe të prodhimit.

viii) Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe matjes dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.

ix) Kërkesat minimale të cilësisë së gazit që do të livrohet sërish dhe instalimet që sigurojnë që cilësia e përcaktuar është arritur.

x) Dëshmi të kontratave/angazhimeve për depozitim.

xi) Kategoritë dhe listën e konsumatorëve (Projekti).

xii) Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta, sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit nr. 102/ 2015 "Për sektorin e gazit natyror"

xiii) Punët e aplikantit për (a) zgjidhjen teknike të propozuar (b) vlerësimin e ndikimit mjedisor (c) vlerësimin e kostos (d) parashikimet ekonomike, duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e depozitimit



nëntokësor të gazit natyror, të përgatitura nga një shoqëri e specializuar.

xiv) Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jetëgjatësia e pritshme e projektit.

xv) Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të hapësirave të depozitimit do të hartohen sipas nenit 56, pika 2 të ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

xvi) Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së hapësirave të depozitimit.

e) Licenca për tregtim të gazit natyror:

Duhet të përmbajë informacion të përgjithshëm që përfshin sa vijon:

i) Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milion Nm³, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti.

ii) Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të Sistemit.

iii) Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej Licensës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.

iv) f. Licensë për Furnizim me Gaz Natyror

Duhet të përmbajë informacion të përgjithshëm që përfshin sa vijon:

i) Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milion Nm³, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti.

ii) Garancinë që cilësia e furnizimit me gaz përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit.

iii) Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.

Licencë për operimin e tregut:

a) Lista e të punësuarve, profesioni, formimi.

b) Dëshmi për posedimin e *hardware*-it dhe *software*-it të nevojshëm për komunikimin me të gjitha pikat e matjes, si dhe me të gjithë pjesëmarrësit në treg (klientët e tyre).

c) Lista e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

Neni 10

Vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit për licencë

1. Pasi shqyrton aplikimin e paraqitur, lidhur me plotësimin e kërkesave të nenit 8 dhe 9, personi i ngarkuar nga drejtoria përgjegjëse përgatit një

relacion, ku i propozon bordit të ERE-s fillimin ose jo të procedurave për shqyrtimin e aplikimit në përputhje me afatet e përcaktuara në rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s dhe në këtë rregullore.

2. Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregullore, duke plotësuar kërkesat dhe dokumentet e kërkuara në të. Në të kundërt, bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurave të shqyrtimit të aplikimit.

3. Bordi i ERE-s mund të vendos për fillimin ose jo të procedurave për shqyrtimin e aplikimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në relacionin e sipërpërmendur.

4. ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

5. Në rast refuzimi, ERE do të njoftojë aplikuesin lidhur me arsyet e refuzimit dhe duke i dhënë udhëzimet e nevojshme brenda 7 ditë pune nga marrja e vendimit.

6. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri sipas kërkesave të kësaj rregullore dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.

7. Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa e kryer për këtë procedurë do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.

8. Në rast të miratimit të fillimit të procedurave për shqyrtimin e aplikimit, brenda 2 ditëve pune nga marrja e vendimit, ERE publikon në median e shkruar për dy ditë me radhë një njoftim për aplikimin e paraqitur në tri gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin që botohen në Tiranë.

9. Njoftimi përmban një informacion të shkurtër për aplikimin e paraqitur; një njoftim që paraqitja e objeksioneve ose ankesave nga personat e interesuar mund të bëhen në ERE brenda afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.

10. Pas publikimit në media të njoftimit, ERE do të sigurojë që për një periudhë 30 ditë pune nga data e parë e publikimit të njoftimit për aplikimet



për licencim në aktivitetin e prodhimit, aplikimi dhe të gjitha dokumentet shoqëruese apo çdo informacion tjetër që janë të disponueshme për inspektimin e publikut në zyrat e saj.

11. Me vendim të bordit të ERE-s, duke marrë parasysh pretendimet e aplikuesit, mund të vendoset që informacione ose dokumente që mund të shkaktojnë dëm tregtar ndaj aplikuesit, të mbahen konfidenciale dhe mund të ndalojë inspektimin e tyre nga ana e palëve të treta.

12. Në çdo rast, ERE njofton aplikuesin për objeksionet e paraqitura ndaj aplikimit për të cilin kanë filluar procedurat e licencimit dhe kërkon sqarime nga aplikuesi për objeksionet e paraqitura nga palët e interesuara.

Neni 11

Vendimmarrja e bordit të ERE-s

1. Me plotësimin e afatit të paraqitjes së kundërshtimeve dhe ankesave, bordi i ERE-s do të vlerësojë aplikimin mbështetur në kriteret e parashikuara prej ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”. Në marrjen e vendimit për të miratuar apo refuzuar një aplikim për licencë sikurse për termat dhe kushtet e kësaj licence, bordi i ERE do të marrë në konsideratë dhe mbështesë vendimin e vet në kriteret që vijojnë:

a) Aplikimin dhe plotësinë e saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në përputhje me këtë rregullore dhe me kërkesat për informacion shtesë, nëse ka pasur të tilla nga ana e ERE-s.

b) Relacionin e drejtorisë përkatëse të ERE-s, të përgatitur në përputhje me pikën 11 të nenit 10.

c) Kundërshtimet dhe ankesat që kanë lidhje me çështjen, nëse ka të tilla, të paraqitura nga palët e interesuara ose prej publikut të gjerë në lidhje me aplikimin në proces vlerësimi.

d) Në rastin e aplikimeve për licenca për transmetim dhe shpërndarje, ekzistencën e licencave ende të vlefshme të lëshuara më parë për të njëjtat aktivitete në vendndodhjen dhe territorin në të cilin aktiviteti i propozuar synon të kryhet.

e) Funkcionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të pajisjeve, impianteve dhe/ose rrjeteve (nuk zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj rregulloreje).

f) Kërkesën për burime të gazit natyror.

g) Kërkesat për sigurinë kombëtare, jetën e banoreve, pronat, shëndetin dhe rendin publik (nuk

zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj rregulloreje).

h) Angazhimet financiare të ndërmarra dhe garancitë e ofruara prej aplikantit.

i) Mbrojtjen e mjedisit (nuk zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj rregulloreje).

j) Promovimin e përdorimit eficient të energjisë në sektorin e gazit natyror.

k) Detyrimet e shërbimit publik të pritshme prej aplikantit, sikurse përcaktuar nga legjislacioni shqiptar e në veçanti ligji nr. 102/ 2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

l) Promovimin e një tregu konkurrues të gazit natyror dhe, të paktën në rastin e furnizimit të konsumatorëve tariforë, principin e kostos më të ulët për furnizim me gaz natyror.

m) Sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me gaz natyror dhe aftësinë për rrjedhje në kah të kundërt të këtij furnizimi brenda Republikës së Shqipërisë.

2. Në përputhje me Rregullat e saj të organizimit dhe funksionimit, ERE do të njoftojë me shkrim të gjithë palët e interesuara për vendimin e bordit brenda 3 ditësh pune prej marrjes së këtij vendimi.

Neni 12

Dhënia ose refuzimi i licencës

1. Bordi i ERE-s do ta marrë vendimin përfundimtar për dhënien ose refuzimin e licencës brenda 90 ditëve nga dita e parë e publikimit të njoftimit në media, duke e mbështetur vendimin e tij në bazë të kriterëve të parashtruara në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

2. Vendimi përfundimtar i bordit do të jetë me shkrim dhe do të përmbajë arsyet për dhënien ose refuzimin e licencës.

3. Vendimi i ERE-s për miratimin ose refuzimin e dhënies së një licence sipas kësaj rregulloreje do të publikohet në Fletoren Zyrtare.

4. Vendimi i ERE-s mundet të apelohe në përputhje me parashikimet e ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

5. Në rastet kur ERE nuk pranon të zgjasë vlefshmërinë një licence, zbatohen kushtet e nenit 16 të kësaj rregulloreje.



KREU III
NDRYSHIMI DHE TRANSFERIMI I
LICENCAVE

Neni 13

Procedurat e ndryshimit të licencave

1. ERE mundet që, me kërkesën e të licencuarit, me iniciativën e vet ose bazuar në një vendim gjykate të formës së prerë, të ndryshojë termat dhe kushtet e një licence që ajo konsideron të përshtatshme, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, mund të vendosë të ndryshojë një licencë në rastet që vijojnë:

a) kur ka ndryshime të disa rrethanave (siç mundet të jenë kuadri ligjor, vendime të gjykatës) që kanë ndodhur ndërmjet datës së lëshimit të licencës dhe datës së kërkesës për ndryshim, ose

b) kur ka ngjarje që sjellin efekte të konsiderueshme në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes ose në tregun e gazit natyror, ose

c) kur ka ndryshime ligjore, teknike ose financiare që e bëjnë të pamundur plotësimin e pjeshëm ose të plotë të termave dhe kushteve të parashikuara në licencë.

3. Nëse ERE vendos të ndryshojë licencën, ajo do t'i lëshojë të licencuarit një licencë të amenduar me ndryshimet e bëra, duke anuluar në këtë mënyrë pjesët e licencës që nuk janë më të vlefshme. Nëse i licencuari kundërshton termat dhe kushtet e licencës së ndryshuar, atëherë do të zbatohen kushtet e nenit 16 të kësaj rregulloreje.

4. Në rastin e një kërkesë nga i licencuari për një ndryshim të licencës së vet, ERE do të zbatojë të njëjtat afate dhe procedura si në rastin e licencimit sikurse përcaktohet nga kjo rregullore. Kjo kërkesë për ndryshim do të përfshijë:

a) Tekstin e propozuar të ndryshimit specifik që është kërkuar.

b) Informacion me shkrim që shpjegon arsyet e kërkesës për ndryshim të licencës.

c) Vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër që vërteton kërkesën e të licencuarit për ndryshimin specifik të licencës.

5. Përpara miratimit të modifikimit të një licence, ERE publikon modifikimet e propozuara dhe shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme, të paraqitura nga palët e interesuara lidhur me këtë modifikim.

Neni 15

Transferimi i pjeshëm ose i plotë i licencës të licencuarit

1. Me kërkesën e të licencuarit, ERE mundet të transferojë licencën pjesërisht ose plotësisht tek një person tjetër në përputhje me ligjin nr. 102/2015. Në rast të transferimit të plotë ose të pjeshëm të pronësisë së aseteve, personi tek i cili do të transferohen asetet, do të aplikojë tek ERE për një licencë të re për aktivitetet që do të transferohen, duke paraqitur dokumentacionin që vijon:

a) Formën e Aplikimit sikurse përcaktuar në pikat 1(a), 1(b) dhe 1(c) të nenit 9.

b) Dokumentacionin ligjor, administrativ dhe pronësor, sikurse përcaktuar në pikën 1(d) të nenit 9.

c) Dokumentacionin dhe garancitë financiare dhe fiskale, sikurse përcaktuar në pikën 1 (e) të nenit 9.

d) Çdo propozim për ndryshim ose zëvendësim në dokumentacionin teknik.

e) Një deklaratë me faktet e plota që kanë të bëjnë me nevojën ose arsyet për transferimin e propozuar.

f) Transferimi do të bëhet sipas kushteve të “Rregullores së procedurave për kalimin e aseteve të të licencuarve”.

3. Me marrjen e vendimit prej ERE-s për fillimin e procedurave për vlerësimin e aplikimit për transferimin e plotë ose të pjeshëm të licencës, ERE do të publikojë aplikimin në përputhje me pikën 5 të nenit 10 të kësaj rregulloreje. Kushtet e pikës 6 të nenit 10 do të zbatohen për të gjitha aplikimet për transferim licence.

4. ERE do të marrë një vendim për miratimin ose refuzimin e aplikimit për transferimin e plotë ose të pjeshëm të licencës brenda 90 ditëve kalendarike prej ditës së fillimit të procedurave për vlerësimin e aplikimit dhe gjatë kësaj periudhe mbajtësi aktual i licencës do të vazhdojë të kryejë shërbimet në përputhje me detyrimet e licencës në fuqi.

5. I propozuari për aplikant për licencë duhet të:

a) ketë aftësitë dhe eksperiencën teknike dhe financiare për të marrë përsipër detyrimet që i takojnë të licencuarit nën këtë licencë;

b) pranojë dhe marrë përsipër të gjithë termat dhe kushtet e licencës përfshirë dhënien e një garancie financiare dhe të një garancie të performancës dhe



c) të jetë i regjistruar dhe në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore për të bërë biznes në Shqipëri.

6. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, çdo transferim i tillë do të jetë i kushtëzuar nga miratimi paraprak me shkrim i ERE-s, i cili nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

7. Njoftimi për një transferim të synuar, përshkruar në pikën 2 të këtij neni, do të shoqërohet të paktën nga sa vijon:

a) Një kopje e dokumentit ligjor të propozuar ose evidencë tjetër dokumentare e transferimit të synuar.

b) Dokumente që kanë lidhje me aplikantin për licencë të propozuar, të cilat do të përfshijnë:

i) Bilancet financiare të audituara dhe të dhëna të tjera për të siguruar bindjen e arsyeshme të ERE-s për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

ii) Të dhëna për identitetin e pronarëve të aplikantit për licencë të propozuar, duke pasur parasysh që për rastin e një shoqërie, aksionet e së cilës janë regjistruar në një bursë të mirënjohur, këto të dhëna do të kërkojnë për pronarët kryesorë (sikurse përcaktuar ose përdorur prej ligjeve ose rregullave në fuqi, në bazë të të cilave këto shoqëri kanë regjistruar aksionet e tyre).

iii) Të dhëna për shoqëritë mëma direkte dhe indirekte, përfshirë identitetin e pronarëve të shoqërisë mëmë finale të aplikantit për licencë të propozuar.

iv) Çdo dokument ose informacion tjetër shtesë që ERE në mënyrë të arsyeshme mund ta gjykojë të nevojshëm për të marrë një vendim për miratimin e transferimit të propozuar.

8. Brenda 90 ditëve kalendarike pas marrjes prej ERE-s të të gjithë dokumentacionit të kërkuar dhe të dhënave të tjera, ERE do të nxjerrë vendimin e vet për miratimin ose refuzimin e transferimit të propozuar. Publikimi dhe marrja e komenteve të publikut do të bëhet sipas dispozitave të nenit 10.

Neni 16

Heqja e licencave

Me iniciativë të ERE-s, personave të interesuar apo mbajtësit të licencës, ERE fillon procedurën për heqjen e licencës në zbatim të parashikimeve të rregullores për procedurat e heqjes së një licence.

KREU V LËSHIMI DHE RREGJISTRIMI I LICENCAVE

Neni 17

Regjistri i licencave

1. Mbas marrjes së vendimit nga ERE për licencimin, transferimin e pjeshëm/të plotë ose ndryshimin e licencës, Licenca përkatëse i lëshohet aplikantit.

2. Një kopje e çdo licence të lëshuar për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e gazit natyror mbahet nga ERE dhe regjistrohet në regjistrin e licencave.

3. Regjistri i licencave do të mbahet me shkrim nga sekretaria e bordit, sikurse edhe në formë elektronike. Ai do të publikohet gjithashtu në faqen e internetit të ERE-s dhe do të rifreskohet rregullisht.

4. Në Regjistrin mbahen informacionet që vijojnë:

- a) numri i regjistrimit të licencës dhe kategoria;
- b) data e miratimit të licencës;
- c) data e lëshimit të licencës;
- d) emri i të licencuarit;
- e) nënshkrimi i përfaqësuesit zyrtar si provë e marrjes e licencës prej të licencuarit;
- f) zona e shërbimit;
- g) adresa e zyrës qendrore të të licencuarit;
- h) përshkrimi i aktivitetit i cili është objekt i licencës së lëshuar;
- i) kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës;
- j) moszbatim i vendimeve të ERE-s për tarifatat.

Neni 18

Informimi i publikut

1. Regjistri i licencave është i disponueshëm për publikun gjatë orarit zyrtar të punës.

2. Mbështetur në kërkesën e argumentuar të aplikantit, ERE mund të vendosë që pjesë të informacionit përbërës të aplikimit, dokumenteve të tij mbështetëse apo shoqëruese, ose në vetë licencën janë me natyrë të ndjeshme komerciale dhe nuk duhet të ekspozohen. I gjithë informacioni i klasifikuar si i tillë do të trajtohet si konfidencial dhe do të jetë i mbrojtur prej ekspozimit, dhe do të trajtohet vetëm sipas një vendimi të ERE-s, i marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.



3. Informacioni konfidencial nuk do të bëhet i diponueshëm për publikun nëse publikimi i tij mundet të sjellë dëme ekonomike.

**KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 19
Amendimi i rregullores**

Kjo rregullore mund të amendohet me vendim të bordit të ERE-s.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ANEKSI A
PAGESA E REGJISTRIMIT DHE PROCEDIMIT TË NJË APLIKIMI**

AKTIVITETI	Licencim	Modifikim	Rinovim	Transferim licence
Operim në impiantet e GNL-së	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Shpërndarje të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Furnizim të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Tregtim të gazit natyror	40 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë

**VENDIM
Nr. 98, datë 4.7.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS PËR
OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË DHE
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ZYRTARIT
TË PAJTUESHMËRISË TË PROPOZUAR
NGA OST SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.”, neni 21 i Direktivës së Energjisë Elektrike 2009/72/EC, neni 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrta të

pajtueshmërisë, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 3092 Prot., datë 5.6.2017, paraqiti pranë ERE-s kërkesën për miratimin e vendimit të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë OST sh.a., me anë të të cilit ka emëruar zyrtarin e pajtueshmërisë, si dhe ka miratuar kontratën e ofrimit të shërbimeve të zyrta të pajtueshmërisë midis OST sh.a. dhe zyrtarit të pajtueshmërisë.

- ERE, me vendimin e bordit nr. 43, datë 15.3.2017, ka vendosur “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.

- Kërkesa e shoqërisë OST sh.a., për miratimin e kontratës së ofrimit të shërbimeve të zyrta të pajtueshmërisë, daton 5.6.2017 dhe është në zbatim të kushteve dhe afateve të parashikuara në



vendimin e bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.” dhe në përmbushje të detyrave të caktuara nga Direktiva 2009/72/EC.

- ERE ka kompetencën për të miratuar kontratën e zyrtarit të pajtueshmërisë.

- Shoqëria OST sh.a., nëpërmjet organeve të saj drejtuese, ka të drejtën të propozojë për miratim në ERE zyrtarin e pajtueshmërisë së zgjedhur nga këto organe.

- Kontrata e zyrtarit të pajtueshmërisë në shtojcën 2 të saj ka listuar kushtet që duhet të përmbushë zyrtari i pajtueshmërisë.

- Shoqëria OST sh.a., në shkresën e saj nr. 3092 Prot., datë 5.6.2017, nuk ka bërë me dije në lidhje me përmbushjen e kritereve të përcaktuara në shtojcën 2 të draftkontratës nga zyrtari i përzgjedhur dhe emëruar nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë të propozuar nga shoqëria OST sh.a.

2. Shoqëria OST sh.a. të dokumentojë plotësimin e kritereve të përcaktuara në shtojcën 2 të draftkontratës nga zyrtari i propozuar për miratim.

3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 99, datë 4.7.2017

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN E SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OST SHA DHE FURNIZUESIT MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 23, DATË 15.2.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pika 4 e VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017, konstatoi se:

- Me vendimin me nr. 23, datë 15.2.2017, bordi i ERE-s ka miratuar “Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit”.

- Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, u paraqit në ERE me shkresën nr. 2933 Prot, datë 7.4.2017, propozimi i shoqërisë OST sh.a. për disa ndryshime në këtë marrëveshje.

- ERE, me vendimin nr. 64, datë 11.5.2017, miratoi fillimin e procedurës “Për disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017”.

- Me shkresën me nr. 100/24 Prot., datë 17.5.2017, publikoi për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve pune.



- Me shkresën nr. 402 Prot., datë 22.5.2017 dhe 421 Prot., datë 30.5.2017, ERE përcolli vendimin me nr. 64, datë 11.5.2017, “Për fillimin e procedurës mbi disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017”, si dhe ndryshimet e kërkuara nga shoqëria OST sha, për marrje mendimi, pranë subjekteve: MEI, Autoriteti i Konkurrencës, OSHEE, KESH, shoqatave AAES, FIAA dhe AREA.

- Shoqata AAES, me shkresën e saj nr. 16/1 Prot., datë 26.5.2017, ka përcjellë në ERE dakortësinë e saj në lidhje me ndryshimet e propozuara nga shoqëria OST sh.a. “Për disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017”.

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 204/2, datë 22.6.2017, u shpreh se nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017, si më poshtë:

- Në nenin 1, pika “Përfaqësues i autorizuar”, bëhet: “Përfaqësues i autorizuar është personi i ngarkuar zyrtarisht nga titullari i kompanisë për ndjekjen e kësaj kontrate”.

- Në nenin 4, pika 4.1 bëhet: “_____ (F) do të informojë OST për sasinë e energjisë elektrike, nominimin me bazë orare, me numra me presje dhjetore deri në tri shifra pas presjes, të energjisë që do të transmetohet për llogari të _____ (F) nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për ditën në avancë, jo më vonë se ora 14.00 të çdo dite (në ditën D, për ditën D+1). Për ditët e fundjavës ose të festave, programi do të jepet në avancë, në ditën e fundit të punës dhe do të përfshijë ditët e pushimit dhe ditën e parë të punës pas pushimit. Programi (nominimi) i deklaruar nga _____ (F) paraqet një tabelë sipas aneksit 2, ku për çdo orë të ditës në avancë, jepet energjia (fuqia, kapaciteti në MW) që parashikohet të furnizohet dhe tërhiqet

(konsumohet) në të gjitha pikat e matjes sipas aneksit 5. _____ (F) ka të drejtë të bëjë ndryshimin e skedulimit ditor, në çdo kohë, me kushtin që versioni i ri i skedulimit (nominimit) të jetë harmonizuar më parë me kaunterpartin përkatës (në anën tjetër të kufirit në rastin e importit, ose me centralin furnizues përkatës brenda vendit) dhe të deklarohet në OST, jo më vonë se 90 minuta para bërjes efektive të ndryshimit në rastin e transaksionit ndërkuftar dhe jo më vonë se 60 minuta para bërjes efektive të ndryshimit për transaksionin e brendshëm, në mënyrë të tillë që nominimi të jetë sa më afër kohës reale të transaksionit”.

- Neni 15, pika 15.1 bëhet: “Menjëherë pas firmosjes së kësaj kontrate, çdo palë do të përcaktojë me shkrim një përfaqësues të autorizuar (përfaqësuesi i autorizuar)”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 100, datë 4.7.2017

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONCENSIONARE” SHPK., NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, 41 pika 1, germa “a” dhe pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 35, pikat 1 dhe 2, 38 pika 2 dhe neni 58 ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 7 dhe 10, pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të



miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2017; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Luçente Konkensionare” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Luçente Konkensionare” sh.p.k. nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Bordi i ERE, me vendimin nr. 186, datë 23.11.2016, është shprehur për mosfillimin e procedurave të licencimit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Luçente Konkensionare” sh.p.k. për shkak të mosplotësisë së dokumentacionit të nevojshëm.

- Me shkresën nr. 61 Prot, datë 23.4.2017, subjekti ka paraqitur kërkesën në ERE për vazhdimin e procedurës në tejkallim të afatit 1-mujor parashikuar në nenin 10, pika 7 e rregullores.

- Me shkresën nr. 334 Prot., datë 8.5.2017, ERE ka njoftuar subjektin për të aplikuar serish për shkak të tejkallimit të afateve brenda të cilave mund të plotësohet dokumentacioni i munguar pas rrëzimit të kërkesës për fillimin e procedurave të miratimit të kërkesës.

- Kërkesa me nr. 84 Prot., datë 17.5.2017, e paraqitur në ERE për vazhdimin e procedurës së licencimit të shoqërisë “Luçente Konkensionare” sh.p.k. është e nënshkruar nga një person i paautorizuar, për të cilin nuk është depozituar prokurë përfaqësimi, personi është i paidentifikuar (i mungojnë gjeneralitetet), nuk disponon vulën e subjektit dhe marrëdhëniet në raport me subjektin janë të papërcaktuara, nuk rezultojnë të jetë administrator i shoqërisë ose përfaqësues, referuar ekstraktit të QKR-së.

- Kërkesa e paraqitur nuk vjen në pajtim me nenet 35, pikat 1 dhe 2, 38, pika 2 dhe 58 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe nenit 7, pika 1, pika 2, germa “a” dhe “b” dhe pika 3, germa “a” dhe “b” të “Rregullores për

procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i paraqitur më poshtë nuk i plotëson kushtet e një aplikimi në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje në nenin 10 të saj për sa vijon:

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.) e paplotësuar.

- Neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC) e paplotësuar.

- Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin) e paplotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Luçente Konkensionare” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 101, datë 4.7.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LËNIEN PENG TË ASETËVE TË
SHOQËRISË “M.T.C ENERGY” SHPK NË
FAVOR TË BANKËS “RAFFEISEN BANK”
SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 20, pika “a”; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6, 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.7.2016;



pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k. për lënie peng asetesh në favor të bankës “Raffaisen Bank” sh.a, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, geramat: “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licencuar); “d” (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen); “i” (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit).

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me germën “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve); “p” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licencuar), të pikës 1, të nenit 7 do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k. për lënie peng të asetëve në favor të bankës “Raffaisen Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 102, datë 4.7.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 3, 6 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19 pika 1 germa “a” e “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

ERE, me vendimin nr. 68, datë 11.5.2017, vendosi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se u konstatua mungesë e dokumentacionit teknik, si dhe mungesa e pagesës së aplikimit për



pajisje me licencën e furnizimit të energjisë elektrike.

ERE, më shkresën nr. 352/2 Prot., datë 22.5.2017, njoftoi subjektin “Albanian Green Energy” sh.p.k. për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 059 Prot., datë 6.6.2017, paraqiti në ERE brenda afateve të përcaktuara në nenin 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dokumentacionin e munguar për të plotësuar aplikimin e tij, si dhe kreu pagesën e aplikimit për pajisjen me licencë furnizimi me energji elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 252 lekë